

V E N D I M
Nr.332, datë 13.5.1996

PËR PRANIMET NË SHKOLLAT E LARTA NË VITIN SHKOLLOR 1996-1997

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Pranimi i studentëve shqiptarë në shkollat e larta bëhet me konkurs, sipas modaliteteve që përcaktohen në statutet e shkollave të lara.

Përjashtim bëjnë rastet:

- a) fituesit e “Medaljes së Artë”;
- b) fituesit e titullit “Sportist i Nivelit të Lartë”, kur kërkojnë të ndjekin studimet në institutin e lartë të kulturës fizike “Vojo Kushi”;
- c) kandidatët nga trevat jashtë kufijve të vendit; e drejta e studimit për këtë kategori do të jepet nga komisionet e ngritura në trevat përkatëse sipas kuotave të caktuara në pasqyrën nr.3 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Kanë të drejtë të regjistrohen për konkurrim, në secilën degë që dëshirojnë, kandidatët që kanë marrë dëftesën e pjekurisë të një shkolle të mesme, përjashtuar shkollat e arsimit të mesëm profesional 2 dhe 3-vjeçar.

Kanë të drejtë të regjistrohen edhe nxënësit shqiptarë që kanë mbaruar shkollat e mesme private të mëposhtme, funksionimi të cilave për vitin shkollor 1995-1996 është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.654, datë 29.11.1995:

- a) Shkolla e mesme “Pjetër Meshkalla”, Shkodër
- b) Kolegji “Preka”, Korçë
- c) Kolegji turk “Mehmet Akif Ersoy”, Tiranë
- ç) Medreseja “Mahmut Dershî”, Tiranë
- d) Medreseja “Ali Korça”, Kavajë
- dh) Medreseja “Liria”, Elbasan
- e) Medreseja “Hoxha Tasim”, Gjirokastrë
- ë) Medreseja e Shkodrës

3. Numri i studentëve që do të pranohen të rinj në vitin shkollor 1996-1997 është 5025, ndarë në degë sipas pasqyrës nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

4. Në Universitetin e Tiranës, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, hapet dega e psikologjisë me afat studimi 4-vjeçar.

Në Universitetin e Shkodrës, dega e drejtësisë dhe dega e administrim-biznesit, emërtohen: Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti Ekonomik. Në këtë universitet pranë Fakultetit të Mësuesisë (cikli i ulët) hapet profili për përgatitjen e mësuesve të arsimit parashkollor me afat studimi 3-vjeçar.

Në Universitetin e Gjirokastrës pranë Fakultetit të Mësuesisë (cikli i ulët) hapet profili për përgatitjen e mësuesve të arsimit parashkollor me afat studimi 3-vjeçar.

5. Për studentët që do të pranohen nga rrethet Mat, Pukë, Tropojë, Has, Malësi e Madhe, Mirditë, Kukës, Librazhd, Mallakastër, Gramsh, Dibër dhe Bulqizë, përveç të drejtës për të konkurruar si gjithë të tjerët, caktohen edhe kuota plotësuese sipas pasqyrës nr.2 që i bashkëngjitet këtij vendimi. Numri i studentëve të pasqyrës nr.2 përfshihet në numrin e studentëve të pasqyrës nr.1 në total sipas degëve.

Kandidatët e rretheve të mësipërme që do të pranohen sipas pasqyrës nr.2, për lehtësimin që u bëhet, detyrohen të lidhin kontratë me këshillin e rrethit për një shërbim 5-vjeçar pas përfundimit të studimeve. Në të kundërt, kandidati do t’i nënshtrohet detyrimeve sipas rregullave që do të caktohen në këtë kontratë.

6. Për studentët e huaj që do të studiojnë në shkollat e larta të Republikës së Shqipërisë, në bazë të marrëveshjeve shtetërore dhe privatisht, caktohen 30 të drejta studimi mbi planin, të cilat administrohen nga Ministria e Arsimit.

7. Në raste të veçanta, Këshilli i Ministrave mund të bëjë shtesa deri në 5 për qind mbi kuotat e miratuara me këtë vendim.

- larta.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Arsimit dhe rektoratet e shkollave të larta.
9. Të gjitha aktet nënligjore që vijnë në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

I PRANIMEVE NE SHKOLLAT E LARTA PER VITIN 1996-1997

Specialiteti	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AAB	ILKF	Gjithe
1 Administrim-Biznes	175			50			40	50	50		365
2 Ekonomist	60										60
3 Finance	150										150
4 Marketing							35				35
5 Menzher							40	50			90
6 Histori	40										40
7 Gjeografi	30										30
8 Gjuhe letersi	75			100	50		50				275
9 Gazetari	35										35
10 Anglisht	90			60	30		30	30	30		270
11 Frengjisht	60										60
12 Italisht	50										50
13 Rusisht*	25										25
14 Gjermanisht	75			40			30				145
15 Matematike 4-vjcare	75							50			125
16 Fizike 4-vjcare	50							25			75
17 Biokimi	50			25	25		25				125
18 Histori-Gjeografi				50	50		50				150
19 Matematike-Fizike				50	50						100
20 Cikli i ulet				130	75		75	75			355
21 Kimi e Pergjithshme	20										20
22 Kimi Ushqimore	30										30
23 Kimi Industriale	25										25
24 Informatike	80										80
25 Drejtesi	150			75				75			300
26 Pune Sociale	75										75
27 Filozofi-sociologji	50										50
28 Mjekesi	200										200
29 Stomatologji	55										55
30 Farmaci	30										30
31 Mekanike		75									75
32 Metalurgji		15									15
33 Tekstil		30									30
34 Elektrik		75									75
35 Elektronik		140									140
36 Nderim		125									125
37 Arkitekture		65									65
38 Hidroteknike		20									20
39 Topogjeodezi		15									15
40 Gjocoll, Min, Ngurte		25									25
41 Shpimi-Shfrytezim											0
42 Prodhim Shtazor			30								30
43 Prodhim Bimor			30								30
44 Inzhinieri Agronomike						50					50
45 Ekonomi Bujqesore*			60								60
46 Administrim per Bujqesi*			75								75
47 Inzhinieri Pyjesh			30								30
48 Perpunim Druri			20								20
49 Veterinari			50								50
50 Art Skenik									20		20
51 Arte Figurative									30		30
52 Muzike									60		60
53 Fizikulture										50	50
54 Infermieri						80		80			160
55 Inzhinieri Detare								20			20
56 Gjuhe Let. Greke					25						25
57 Inzhinieri Ambienti		30									30
58 Cikli i ulet Parashkollor				60	40	40	40				180
59 Inzhinieri nafte		15									15
60 Miniera		30									30
61 Hortikulture			25								25
62 Psikologji	25										25
Gjithsej	1780	660	320	640	345	390	500	230	110	50	5025

KUOTA PLOTESUESE PER DISA RRETHE VITI 1996 -1997

Pasq. %

Nr. Specialiteti	GR	HAS	KU	LB	MM	MA	MT	MR	PU	TO	DI	BU	Gjithë	
1 Administrim-Biznes	2	2	2	3	2	2	2	2	2	2	2	3	2	26
2 Ekonomist														0
3 Finance	2	2	2	3	2	2	2	2	2			2	2	26
4 Marketing														0
5 Turizem														0
6 Histori														0
7 Gjeografi														0
8 Gjuhe leterare	1	2	2	2	1	1	2	1	1	1	2	2	18	
9 Gazetar														0
10 Anglisht	2	3	3	3	3	2	3	2	3	3	3	2	32	
11 Frengjisht														0
12 Italisht														0
13 Rusisht														0
14 Gjermanisht														0
15 Matematike 4-vjecare	2	2	3	3	2	2	3	2	2	2	3	3	29	
16 Fizike 4-vjecare	1	1	1	3	1	1	3	1	1	1	2	1	17	
17 Biologji	1	1	2	1	1	1	1	2	2	2	2	1	17	
18 Histori-Gjeografi														0
19 Matematike-Fizike	2	2	3	4	2	2	3	2	2	2	3	2	35	
20 Cikletat e ulët	2	2	3	3	2	2	4	3	3	3	4	2	33	
21 Kimi e Përgjithshme														0
22 Kimi Ushqimore														0
23 Kimi Industriale														0
24 Informatike	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	2	1	13	
25 Drejtesia	3	3	4	3	3	3	3	3	3	3	4	3	38	
26 Punë Sociale														0
27 Filozofi-sociologji														0
28 Mjekësi	2	3	4	4	3	2	3	3	3	3	3	2	35	
29 Stomatologji														0
30 Farmaci														0
31 Mekanike														0
32 Metalurgji														0
33 Tekstil														0
34 Elektronik	2		3	1			1			3	3	1	19	
35 Elektronik	2	2	3	2	2	2	1	2	2	2	3	2	25	
36 Ndërtim			2	2		1	3	1			2	1	12	
37 Arkitektura				1			1				1	1	4	
38 Hidroteknike														0
39 Topogjeodezi														0
40 Gjeol. Min. Ngurte														0
41 Shpim-Shfrytëzim														0
42 Prodhim Shtazor														0
43 Prodhim Bimor														0
44 Inxhinieri Agronomike														0
45 Ekonomi Bujqesore														0
46 Administrim për Bujqësi														0
47 Inxhinieri Pyjesh														0
48 Përpunim Druri														0
49 Veterinarian														0
50 Art Skenik														0
51 Arte Figurative														0
52 Muzikë														0
53 Fizikulture														0
54 Infermier	2	2	3	3	2	1	4	1	2	1			21	
55 Inxhinieri Detare														0
56 Gjuhe Let. Greqe														0
57 Inxhinieri Ambient														0
58 Cikletat e ulët Parashkollor														0
Gjithsej	27	28	43	42	27	25	42	28	32	33	45	28	400	

Shënim: GR - Gramsh, KU - Kukes, LB - Librazhd, MM - Malsi e Madhe, MA - Mallakaster, MT - Mat, MR - Mirdite, PU - Puke, TO - Tropoje, DI - Diber, BU - Bulqize.

PLANI I PRANIMEVE
PER STUDENTET SHQIPTARE NGA TROJET JAShte VENDIT PER VITI 1996 - 97

Nr.	ISpecialiteti	IShqiperia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Presheve, Bujanovc, Medvegje.	Gjithesj
1	142: Menaxhim-Biznes	349	5	6	2	3	365
2	2: Ekonomist	56	2	2	0	0	60
3	3: Finance	141	2	3	1	3	150
4	4: Marketing	32	1	2	0	0	35
5	5: Turizem	87	1	1	1	0	90
6	6: Histori	36	1	2	1	0	40
7	7: Gjeografi	26	1	2	1	0	30
8	8: Gjuhe leteresi	264	2	5	2	2	275
9	9: Gazetar	27	3	3	1	1	35
10	10: Anglisht	260	3	4	1	2	270
11	11: Frengjisht	60	0	0	0	0	60
12	12: Italisht	50	0	0	0	0	50
13	13: Rusisht	25	0	0	0	0	25
14	14: Gjermanisht	144	1	0	0	0	145
15	15: Matematike 4-vjcare	117	1	4	1	2	125
16	16: Fizike 4-vjcare	72	1	2	0	0	75
17	17: Biokimi	115	3	4	1	2	125
18	18: Histori-Gjeografi	145	0	4	1	0	150
19	19: Matematike-Fizike	94	0	5	1	0	100
20	20: Cikli i ulet	342	0	10	3	0	355
21	21: Kimi e Pergjithshme	16	2	2	0	0	20
22	22: Kimi Ushqimore	23	5	2	0	0	30
23	23: Kimi Industriale	22	1	2	0	0	25
24	24: Informatike	74	2	2	0	2	80
25	25: Drejtesi	291	2	5	1	1	300
26	26: Pune Sociale	74	1	0	0	0	75
27	27: Filozofi-sociologji	50	0	0	0	0	50
28	28: Mjekesi	178	10	8	2	2	200
29	29: Stomatologji	48	3	2	0	2	55
30	30: Farmaci	19	8	2	0	1	30
31	31: Mekanike	68	2	3	1	1	75
32	32: Metalurgji	15	0	0	0	0	15
33	33: Tekstil	27	3	0	0	0	30
34	34: Elektrik	69	2	3	1	0	75
35	35: Elektronik	132	2	3	1	2	140
36	36: Nderim	116	2	4	0	3	125
37	37: Arkitekture	59	2	2	1	1	65
38	38: Hidroteknike	20	0	0	0	0	20
39	39: Topogjeodezi	13	0	0	0	2	15
40	40: Gjeool. Min. Ngurte	23	0	2	0	0	25
41	41: Shpim-Shfrytezim	0	0	0	0	0	0
42	42: Prodhim Shtazor	28	0	2	0	0	30
43	43: Prodhim Bimor	27	1	1	0	1	30
44	44: Inxhinieri Agronomike	47	1	2	0	0	50
45	45: Ekonomu Bujqesore	57	0	5	0	0	60
46	46: Administrim per Bujqesi	75	0	0	0	0	75
47	47: Inxhinieri Pyjesh	23	5	2	0	0	30
48	48: Perpunim Drun	16	2	2	0	0	20
49	49: Veterinari	34	10	3	0	3	50
50	50: Art Skenik	18	2	0	0	0	20
51	51: Arte Figurative	27	1	2	0	0	30
52	52: Muzike	58	2	0	0	0	60
53	53: Fizikulture	42	2	3	1	2	50
54	54: Infermieri	145	9	4	0	2	160
55	55: Inxhinieri Detare	20	0	0	0	0	20
56	56: Gjuhe Let. Greke	25	0	0	0	0	25
57	57: Inxhinieri Ambienti	29	1	0	0	0	30
58	58: Cikli ulet Parashkollor	180	0	0	0	0	180
59	59: Inxhinieri natfe	15	0	0	0	0	15
60	60: Miniera	30	0	0	0	0	30
61	61: Hortikulture	25	0	0	0	0	25
62	62: Psikologji	25	0	0	0	0	25
	Gjithesj	4725	110	125	25	40	5025